



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PAJAZITI THOTË SE QEVERIA KURTI ÇËSHTJEN E DINARIT E BËRI TEMË NË DIALOG

FAQE 4-5



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti, se rregulloren e BQK-së që ndalon

përdorimin e dinarit për pagesa brenda Kosovës e ka bërë temë në dialog. Ai ka theksuar se veprimet e qeverisë, të pakoordinuara me aleatët, po i kushtojnë shumë

vendit. Sipas Pajazitit, raportet e Kosovës me aleatët ndërkombëtarë, veçmas me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë shqetësuese


AKTUALE



ZELENSKY: 31 000 USHTARË UKRAINAS U VRANË NË LUFTË, SHPRESOJ PËR SAMIT TË PAQES SË SHPEJTI F. 2

OSMANI NË KATAR: KOSOVA ME POTENCIAL TË JASHTËZAKONSHËM PËR INVESTIME F. 3

POLICIA E ZBULON NJË LABORATOR DROGE NË LEPOSAVIO, E ARRESTON NJË TË DYSHUAR F. 6



EKONOMI



AFARISTËT SERBË ANKOHEN PËR KUSHTET EKONOMIKE NË KOSOVË F. 8

SPORT



GARA PËR TITULL BËHET EDHE ME INTERESANTE F. 10

ESCOBARI: QEVERIA E KOSOVËS NUK PO E TRAJTON SHBA-në PARTNERE

F.4



NË KUÇOVË BËHET GATI BAZA AJRORË TAKTIKE E NATO-s

F.7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: 31 000 ushtarë ukrainas u vranë në luftë, shpresoj për samit të paqes së shpejti

KIEV, 25 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë të dielën se 31 000 ushtarë ukrainas janë vrarë prej që Rusia nisi pushtimin e Ukrainës para dy vjetëve. Duke folur në një konferencë për medie në kryeqytetin ukrainas për shënimin e dyvjetorit të pushtimit nga Rusia - i cili nisi më 24 shkurt 2022 - Zelensky shpresoi se një samit i liderëve botërorë do të mbahet në Zvicër në muajt e ardhshëm për të biseduar për vizionin e tij për paqe. "Deri tani në këtë luftë janë vrarë 31 000 pjesëtarë të ushtrisë. Jo 300 000, jo 150 000, e as sa [presidenti rus Vladimir] Putin dhe rrethi i tij mashtrues kanë gënjer. Por, sidoqoftë, secila prej këtyre humbjeve është flim i madh për ne", tha Zelensky.



Zelensky shtoi se nuk do të flasë për numrin e të plagosurve për shkaqe sigurie. Duket se kjo është hera e parë që Ukraina flet zyrtarisht në

hollësi për numrin e përgjithshëm të ushtarakë të vrarë. Herën e fundit kur Kievi foli për numrin e humbjeve në betejë

ishte në fund të vitit 2022, kur zyrtari presidencial Mykhailo Podolyak tha se 10 000 deri në 13 000 ushtarë ukrainas ishin vrarë. Zelensky pretendoi se humbjet e Rusisë janë 180 000 ushtarë të vrarë dhe 500 000 të plagosur në këtë luftë, që është shifër shumë më e lartë se vlerësimet e deritanishme, por e pamundur për t'u konfirmuar. Rusia nuk i zbulon humbjet në luftë. Më 24 shkurt, presidentja e Zvicrës, Viola Amaherd, tha se vendi i saj neutral shpreson se do ta mbajë një konferencë të nivelit të lartë për paqe në muajt në vijim. "Shpresoj se [samiti] do të mbahet këtë pranverë. Ne nuk duhet ta humbim këtë nismë diplomatike", tha Zelensky.

Ai shtoi se pret që kjo nismë e paqes t'i paraqitet Moskës. Ndërkohë, Zelensky tha se fitorja e Ukrainës në këtë luftë varet nga mbështetja prej Perëndimit, e cila është përballur me rezistencë kryesisht nga ligjvënësit e Partisë Republikane në Shtetet e Bashkuara. Ai tha në konferencë se është i sigurt se paketa vendimtare me ndihmë për Ukrainën do të miratohet përfundimisht nga Senati amerikan. "Se a do të humbë, apo se a do të fitojë Ukraina, do të jetë e vështirë për ne, dhe nëse do të ketë numër të madh të viktimave, kjo varet nga ju, nga partnerët tanë, nga bota perëndimore", tha Zelensky. Ai shtoi se "ka shpresë për Kongresin. Dhe, jam i sigurt se do të jetë pozitive".

Bujqit polakë e bllokojnë një autostradë kyçe me Gjermaninë

BERLIN, 25 SHKURT - Bujqit polakë e bllokuan të dielën një autostradë të madhe me Gjermaninë gjatë protestës së tyre më të fundit kundër rregulloreve dhe tatimeve të Bashkimit Evropian (BE). Bujqit nëpër Evropë janë duke protestuar tash e disa javë kundër, siç thonë ata, rregulloreve mjedisore tejet kufizuese, konkurrencës nga importet e lira prej vendeve që nuk janë pjesë e BE-së, si dhe kundër të hyrave të vogla. Të dielën bujqit nga Polonia e bllokuan autostradën A2 në lindje të kufirit me Gjermaninë. "Bllokada nisi në orën 13:00. Të

dyja anët e autostradës A2 janë bllokuar", tha Ewa Murmylo, zëdhënëse e policisë lokale. Bujqit kishin planifikuar fillimisht një bllokadë 25-ditore, por pas bisedimeve me përfaqësuesit lokalë, bizneset dhe transportuesit, vendosën për bllokadë më të shkurtër. Ata kanë vendosur "ta zhblokojnë rrugën mbase nesër", e hënë, tha Dariusz Wrobel, një nga bujqit dhe organizatorët e protestës. "Kjo do të varet nga gjërat të cilat ne nuk mund t'i parashikojmë. Ne duhet të fillojmë të marrim veten seriozisht", tha ai për AFP. Të hënë ministrat e Bujqësisë të

BE-së pritet të takohen në Bruksel. Ata pritet të bisedojnë për propozimet e reja të Komisionit Evropian për ndryshimin e rregulloreve që kanë nxitur pakënaqësi të mëdha në mesin e bujqve. Bujqit në Poloni thonë se po e shënjestrojnë të ashtuquajturën Marrëveshje të Gjellbër të Bashkimit Evropian për energjinë, transportin dhe taksat. Kjo marrëveshje, sipas bllokut, synon t'i ulë emetimet e gazrave serrë. Bujqit veçmas janë goditur nga rritja e taksave dhe rregullave të tjera. Bujqit polakë kishin protestuar



edhe në kufi me Ukrainën, duke përkeqësuar raportet mes këtyre dy shteteve, pavarësisht se

Varshava është një mbështetëse e madhe e Kievit në luftën e tij kundër pushtimit rus.

Trupi i Navalnyt i dorëzohet nënës së tij, njofton ish-zëdhënësjë e tij

Moskë, 25 shkurt - Trupi i liderit opozitar rus Alexei Navalny, i cili vdiq papritmas në burg javën e kaluar, i është dorëzuar nënës së tij, njoftoi të shtunën ish-zëdhënësjë e tij, Kira Yarmysh. Yarmysh tha se nuk e di nëse autoritetet ruse do ta lejojnë mbajtjen e varrimit të tij "në mënyrën se si familja dëshiron dhe në mënyrën se si Alexei e meriton". Trupi i Navalnyt iu dorëzua nënës së tij Lyudmila Navalnaya pak kohë pasi asaj i ishte kërkuar të pajtohej për "varrosjen e tij fshehurazi", ose ndryshe ai do të varrosej në burgun ku vdiq. Yarmysh i falënderoi të gjithë ata që kishin kërkuar kthimin e



trupit të tij te familja. Nëna e Navalnyt e kaloi javën e kaluar në qytetin afër burgut ku ai vdiq, duke u përpjekur së pari ta gjejë vendndodhjen e trupit të tij dhe duke kërkuar pastaj që

trupit të tij t'i dorëzohej. Pasi e nënshkroi një certifikatë të vdekjes së tij ku thuhej se ai ka vdekur nga shkaqe natyrore, asaj i ishin dhënë tri orë kohë për t'u pajtuar për ta varrosur

"fshehurazi" të birin. Nëse nuk do të pajtohej, trupi i tij do të varrosej në oborrin e burgut ku vdiq, i ishte thënë nënës së tij, sipas Yarmysh. Por, Lyudmila nuk kishte pranuar të negocionte me autoritetet. Të shtunën e veja e Navalnyt, Yulia Navalnaya, e akuzoi presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, se po e mbante "peng" trupin e burrit të saj dhe i kërkoj ta lironte atë pa asnjë kusht. Ajo përsëri e akuzoi presidentin rus se është përgjegjës për vdekjen e burrit të saj. Kremli i ka mohuar akuzat, ndërsa reagimet e Perëndimit për vdekjen e tij i ka cilësuar "histerike".

Navalny vdiq më 16 shkurt në një burg rus në Arktik. Navalny ka qenë kritiku më i madh i liderit rus për vite të tëra. Në gusht të 2020-s, Navalny ishte helmuar me agent nervor Novichok, dhe atëbotë e kishte fajësuar aparatit shtetëror, në krye me Putinin, për atë vendim. Navalny ishte shëruar në Gjermani pas helmimit, dhe në ditën e kthimit në Rusi, ishte dërguar në burg. Përpjekjet për ta përkujtuar vdekjen e tij janë shtypur nga autoritetet ruse, të cilat i kanë larguar memorialet e improvizuara për nder të tij në disa qytete ruse, si dhe i kanë arrestuar qindra njerëz.

Në Kuçovë bëhet gati baza ajrore taktike e NATO-s

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë tha të dielën se përgatitjet janë drejt përfundimit për bazën ajrore të aleancës ushtarake të NATO-s në qytezën jugqendrore të Shqipërisë, Kuçovë, para se ajo të përurohet më 4 mars. Komandanti i Forcës Ajrore të Shqipërisë, gjeneralbrigade Ferdinand Dimo, tha se trupat e NATO-s dhe mjetet fluturuese të saj së shpejti do të akomodohen, stërviten dhe fluturojnë duke u nisur nga baza ajrore e Kuçovës, tashmë bazë ajrore taktike e NATO-s. Shqipëria është anëtare e NATO-s që prej vitit 2009. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi,

në rrjetet sociale theksoi se kjo bazë do të luajë rol kyç në mbështetjen e operacioneve dhe stërvitjeve të NATO-s. "Kjo bazë do të shërbejë si qendër për aktivitetet e Forcës sonë Ajrore, duke ofruar infrastrukturë të avancuar për avionët luftarakë dhe ata të transportit të Aleancës. Ky hap shënon një fazë të re në forcimin e kapaciteteve tona për bashkëpunim ndërkombëtar dhe siguri rajonale", ka shkruar Peleshi në "Facebook".

Baza e Kuçovës u përmend edhe nga sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, gjatë vizitës së tij në Tiranë më 15 shkurt. "Përgjatë 15 viteve të saj në NATO Shqipëria ka dhënë kontribute domethënëse për aleancën tonë. Muajin e ardhshëm do të përurohet baza ajrore e NATO-s



në Kuçovë", tha Blinken.

Punimet për rikonstrukcionin e saj nisën në janar të vitit 2022. Prej asaj kohe është punuar për sistemin e rrethimit dhe të sigurisë, po ashtu të mbrojtjes në perimetrin ku shtrihet kjo bazë. Nga NATO janë investuar afërsisht 50 milionë euro dhe më shumë se 5 milionë euro janë investuar nga qeveria shqiptare. Autoritetet shqiptare kanë marrë përsipër ndërtimin e perimetrit të sigurisë dhe rrugëve lidhëse, ndriçimit, vendosjen e kamerave të sigurisë së bazës si dhe të sensorëve të

zbulimit të ndërhyrjeve përgjatë rrethimit të bazës.

Në kohën kur nisi ndërtimi i kësaj baze, ministri Niko Peleshi pati deklaruar se ky ishte një mesazh i qartë "për aktorët e tjerë me qëllime të këqija" në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Për autoritetet shqiptare përzgjedhja e bazës së Kuçovës lidhet sa me pozicionin gjeostrategjik të vendit, si dhe të vet aeroportit, aq dhe me besueshmërinë që Shqipëria ka krijuar në gjirin e aleancës ushtarake.

Në ceremoninë për përurojen e bazës ajrore do të marrin pjesë përfaqësues të lartë të shtetit shqiptar, të NATO-s dhe të ShBA-së.

Baza ajrore e Kuçovës është ndërtuar në vitet 1950, por doli jashtë përdorimit në vitet '90. Pas rikonstrukcionit të bazës së Kuçovës, qeveria e kryeministrit Edi Rama kërkoi të procedohej sa më shpejt në lidhje me aplikimin e Shqipërisë për ta bashkëfinancuar me NATO-n rikonstrukcionin e bazës së re detare në Porto Romano.

Osmani në Katar: Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm për investime

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po qëndron për vizitë në Katar, ka marrë pjesë në tryezën ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të Katarit që po mbahet në Doha e ku po diskutohet për potencialin investues në vendin tonë. Në këtë tryezë ekonomike me pjesëmarrje të Odës Ekonomike

të Katarit dhe bizneseve anëtare katariane, kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, edhe disa nga afaristët më të suksesshme nga Kosova, u diskutua për mundësitë e shumta për partneritete biznesore dhe investime në sektorë strategjikë.

Duke folur për potencialin zhvillimor të Kosovës, presidentja Osmani potencoi faktin se Kosova ka tashmë një infrastrukturë ligjore të përafëruar me ligjet e BE-së, një sistem të standardizuar të

taksave me standardet më të mira ndërkombëtare, një ambient miqësor për investitorët e huaj dhe potencial të jashtëzakonshëm për investim në fusha të ndryshme.

Presidentja Osmani, ndër të tjera, veçoi mundësitë e shumta për bashkëpunim në industrinë e ushqimit dhe sigurisë ushqimore, energjisë, hotelerisë dhe turizmit malor, industrisë së drurit dhe asaj metalike.

Ndërkaq kryetari Rama paraqiti

planin për zhvillimin e Prishtinës, me fokus te një sërë projektesh kapitale e infrastrukturore nga fusha e sportit, artit, transportit e më gjerë. Kjo tryezë shërbeu edhe si platformë për bizneset e Kosovës për t'i promovuar bizneset e tyre dhe për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me bizneset katariane.

Gjatë tryezës ekonomike u vunë në pah mundësitë e shumta për partneritete e projekte të

përbashkëta dhe pritjet që së shpejti një delegacion i bizneseve të Katarit ta vizitojë Kosovën me qëllim të konkretizimit të bashkëpunimit.

Gjatë kësaj vizite në Katar, presidentja Osmani do të zhvillojë takime edhe me zyrtarë shtetërorë të Katarit, ku do të diskutohen për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve si dhe do të mbajë fjalim në WebSummit, i cili sivjet po mbahet në Doha.



Escobari: Qeveria e Kosovës nuk po e trajton ShBA-në partnere

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se ShBA-ja është e shqetësuar për faktin se Qeveria e Kosovës nuk po e trajton si partnere. “Ata nuk punojnë me ne për stabilitetin rajonal dhe minojnë dialogun, proces për të cilin ShBA-ja është e përkushtuar plotësisht. Mendoj se ambasadori [amerikan në Kosovë, Jeffrey] Hovenier e ka thënë më së miri: kjo ndërlikon kapacitetin tonë për ta ndihmuar Kosovën që të integrohet në komunitetin transatlantik”, ka theksuar Escobari

PRISHTINË, 25 SHKURT - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, tha se Qeveria e Kosovës, me mospërmbushjen e kërkesës amerikane për çështjen e dinarit serb, nuk po e trajton Uashingtonin si partner. “Nuk dua të flas se cilat janë të gjitha pasojat, por mendoj se deklaratat tona publike kanë treguar qartë se ku po shkojnë raportet tona diplomatike dhe politike. Ne jemi shumë të shqetësuar sepse Qeveria e Kosovës nuk po na trajton si partnerë. Ata nuk punojnë me ne për stabilitetin rajonal dhe minojnë dialogun, proces për të cilin ShBA-ja është e përkushtuar plotësisht.

Mendoj se ambasadori [amerikan në Kosovë, Jeffrey] Hovenier e ka thënë më së miri: kjo ndërlikon kapacitetin tonë për ta ndihmuar Kosovën që të integrohet në komunitetin transatlantik”, tha Escobari në një intervistë dhënë për Zërin e Amerikës në gjuhën serbe. Në Kosovë ka hyrë në fuqi që nga 1 shkurti një rregullore e re e Bankës Qendrore të Kosovës e cila parasheh që vetëm euroja të jetë valuta për kryerjen e pagesave me para të gatshme. ShBA-ja ka kërkuar shtyrjen e zbatimit të këtij vendimi, duke argumentuar se ai është miratuar pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë ndikimet negative të

komuniteti serb në Kosovë, që përdor valutën kombëtare të Serbisë. Escobari tha se mospërfillja e kërkesave amerikane vështrëson punën e ShBA-së që ta ndihmojë Kosovën në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës, NATO dhe Bashkim Evropian. “Sa herë që ne flasim për Kosovën me partnerët e tjerë, veçmas me ata që nuk e njohin atë, ata e shohin se Kosova nuk përmbush obligimet e saj të dialogut që është nën ombrellën e BE-së, që përfaqëson të gjithë BE-në. Prandaj, na bëhet e vështirë që të mbrojmë në çfarëdo mënyre argumentet e Kosovës,

përfshirë anëtarësimin në BE dhe NATO, në Këshillin e Evropës dhe në shumë organizata të tjera”, tha Escobari.

Sipas zyrtarit të lartë amerikan, Kosova duhet ta zbatojë marrëveshjen e arritur në dialogun e Brukselit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai tha se përmes këtij asociacioni do të mund të zgjidhej edhe çështja e përdorimit të dinarit serb. Escobari tha se një zgjidhje për dinarin përmes Asociacionit do të duhej të bëhej përmes një procesi transparent dhe në përputhje me ligjet e Kosovës. Më herët gjatë këtij muaji, ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O’Brien, ka deklaruar se ShBA-ja mund të mos e trajtojë Kosovën si partnere nëse ajo merr vendime pa u konsultuar me të.

Pas kësaj deklaratë të zyrtarit të lartë amerikan, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se nuk po rrezikohet

partneriteti me ShBA-në. Por, ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka thënë se vendimi i ndalimit të dinarit veçse ka ndikuar në cilësinë e raporteve mes ShBA-së dhe Qeverisë së Kosovës.

Ndërkaq, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deklaroi më herët gjatë të premtës se çështja e ndalimit të dinarit serb në Kosovë mund të zgjidhet brenda vendit dhe se ajo nuk është dashur të shkaktoje përplasje në mes të Prishtinës dhe aleatëve të saj. Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre në dinarë - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

BQK-ja ka thënë se rregullorja do të zbatohet përmes një tranzicioni të lehtësuar, që do të zgjasë jo më shumë se tre muaj. Ndërkaq, nga ekzekutivi i Kosovës kanë thënë se së shpejti do të dalin me një listë prej dhjetë masash lidhur me mënyrat se si qytetarët të mos dëmtohen gjatë fazës kalimtare të zbatimit të vendimit.

Pajaziti thotë se qeveria Kurti çështjen e dinarit e bëri temë në dialog

Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti se rregulloren e BQK-së që ndalon përdorimin e dinarit për pagesa brenda Kosovës e ka bërë temë në dialog. Ai ka theksuar se veprimet e qeverisë, të pakoordinuara me aleatët, po i kushtojnë shumë vendit. Sipas Pajazitit, raportet e Kosovës me aleatët ndërkombëtarë, veçmas me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë shqetësuese

PRISHTINË, 25 SHKURT - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Zenun Pajaziti, e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti, se rregulloren e BQK-së që ndalon përdorimin e dinarit për pagesa brenda Kosovës e ka bërë temë në dialog. Ai thotë se për shkak të qasjes së gabuar dhe populiste të Kurtit, çështjet e brendshme të Kosovës po bëhen temë në dialogun me Serbinë në Bruksel.

Pajaziti, në një intervistë për "KosovaPress", thotë se veprimet e qeverisë, të pakoordinuara me aleatët, po i kushtojnë shumë vendit. Megjithatë nga ekzekutivi kanë thënë se nuk do të paraqiten në nivelin politik, në takimin e thirrur nga BE-ja, më 27 shkurt në Bruksel, Pajaziti deklaroi se qeveria s'ka bërë asnjë përpjekje kreative për ta trajtuar këtë çështje me partnerët ndërkombëtarë në Kosovë. "Po t'i lihej në dorë BQK-së ose po të

mos përzihej qeveria me tendenca që të nxjerrë këtë çështje me populizëm si një sukses të qeverisë, kjo do të zgjidhej më mirë. Qeveria s'ka bërë asnjë përpjekje kreative për ta trajtuar këtë çështje. Për më tepër e ka ngritur çështjen e dinarit si një çështje të dialogut. Kjo qeveri ka përgjegjësi të plotë që dinarin e bëri temë të tillë, e cila po i kushton qeverisë dhe neve si vend. Këta sikur edhe herëve të tjera kanë hyrë në tema pa një marrëveshje me partnerët, me ata që vazhdimisht kemi pasur koordinim të plotë dhe pastaj tërheqja na ka kushtuar shumë", shton ai.

Sipas tij, raportet e Kosovës me aleatët ndërkombëtarë, veçmas me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë shqetësuese. "Kemi një situatë, e para prej se ne jemi shtet i pavarur që na është dhënë një qëndrim i tillë prej Shteteve të Bashkuara të



Amerikës dhe prej aleatëve tanë sikurse ky tani. Çështjet si kjo që qeveria jonë i ka trajtuar për zgjidhje, në mënyrën si i ka trajtuar, siç është dinari dhe çështja e mëhershme e tabelave, janë mënyra më populiste të trajtimit të tyre. Nuk kemi të bëjmë me një seriozitet të zgjidhjes së këtyre problemeve që kanë qenë pjesë e dialogut, por veprime krejtësisht populiste, që më shumë sesa një tentim për t'i zgjidhur këto probleme njëherë e mirë, kanë për qëllim joshjen e votuesve për proceset e ardhshme zgjedhore. Kjo e dëmton veçanërisht interesin tonë si vend dhe relacionin me partnerët tanë dhe miqtë tanë për më tepër", ka theksuar Pajaziti.

Vendimin për dinarin Pajaziti e

sheh të ndërlidhur edhe me tendencat, siç thotë, për ta zvarritur zbatimin e obligimeve në dialog, që rrjedhin nga marrëveshja e Brukselit e arritur vitin e kaluar. "Ne nuk e dimë fare se cili është qëllimi i kësaj qeverie. A po punon për implementimin e kësaj marrëveshje. A është e koordinuar me partnerët kyçë dhe cili është qëllimi i saj. Ne po mbetemi peng i një procesi i cili po zvarritet, tash jo vetëm nga Beogradi, të cilën e dimë të gjithë, por edhe nga Prishtina. Partnerët tanë po kërkojnë që qoftë edhe njëanshëm të ecet në procesin e dialogut, në mënyrë që t'i kemi në krah partnerët", thotë Pajaziti.

Në anën tjetër, duke folur për mundësinë e zgjedhjeve të reja

në Kosovë, ai thotë se PDK-ja është gati për të njëjtat dhe se ky vit mund të jetë elektoral. "Është viti i cili mund të jetë elektoral. Ne si PDK kemi kërkuar qysh vitin e kaluar procese zgjedhore dhe kemi paralajmëruar qytetarët se kjo qeveri mund të sjellë vendin në këtë pozicion që është tash, sidomos në raport me proceset kyçë dhe në raport me partnerët tanë. Kemi paralajmëruar dhe kemi kërkuar zgjedhje. Ne kemi menduar se kjo qeveri s'ka vizion dhe guxim për ta mbyllur një proces kaq të rëndësishëm. Prandaj kemi kërkuar zgjedhje. Me vetë faktin se qysh vitin e kaluar ne kemi kërkuar zgjedhje, nënkupton se ne jemi të gatshëm për këtë proces", ka thënë Pajaziti.

"Mjekët me pagat më të larta në Ballkan", Haxhiu i reagon Vitisë, i tregon sa paguhen profesionistët shëndetësorë në vendet e rajonit

PRISHTINË, 25 SHKURT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, e ka quajtur krejtësisht të pavërtetë deklaratën e ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili ka thënë se mjekët në Kosovë paguhen më mirë se në Ballkan. Haxhiu në një prononcim "Blic"-in ka theksuar se pagat e ulëta janë arsyeja që profesionistët shëndetësorë po e braktisin Kosovën. "Deklarata e ministrit Vitia është tërësisht e pavërtetë. Në Kosovë pagat e mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë janë ndër më të ulëtat jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë. Kjo është edhe një nga arsyet pse ata po e braktisin Kosovën. Po sikur pagat në Kosovë do të ishin në nivelin e duhur, nuk do të kishte ikje të mjekëve dhe të profesionistëve shëndetësorë, nuk do të kishte



pakënaqësi dhe as protesta e greva të punëtorëve shëndetësorë", ka thënë ai. Sipas Haxhiut, me Ligjin e ri të

Pagave po diskriminohen specialistët dhe profesionistët shëndetësorë. "Nuk ka vlerësim të specialistëve dhe

profesionistëve të tjerë. Me Ligjin e Pagave ka pabarazi dhe diskriminim, andaj Gjykata Kushtetuese ka kërkuar që ky ligj

të ndryshohet deri më 1 gusht 2024", ka thënë Haxhiu. Ai ka treguar disa nga pagat e mjekëve në vendet e rajonit. "Në Rumani paga e një mjeku specialist është 4 000 euro, derisa e një subspecialistit deri në 7 000 euro. Në Mal të Zi paga e një mjeku specialist fillon nga 2 500 euro, derisa ajo e një mjeku subspecialist është rreth 3 000 euro. Në Kroaci paga e një mjeku është 2 797 euro, derisa një subspecialist paguhet 2 965 euro. Në Bosnjë-Hercegovinë paga e një mjeku specialist është 2 000 euro. Në Slloveni paga e një mjeku specialist fillon nga 2 000 euro deri në 3 000 euro, derisa ajo e një subspecialistit fillon prej 4 000 euro. Në Maqedoni të Veriut paga e një mjeku specialist është 1 500 euro. Në Shqipëri dhe Bullgari paga e një mjeku specialist shkon deri në 2 000 euro", ka treguar Haxhiu.

KFOR-i tërheq njësitë nga ndërtesa e komunës së Zveçanit

ZVEÇAN, 25 SHKURT - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, njoftoi të dielën se i ka tërhequr njësitë e veta nga ndërtesa e komunës së Zveçanit, duke vlerësuar se gjendja e sigurisë në qytetin verior të Kosovës është stabilizuar.

Në një komunikatë për medie, KFOR-i, megjithatë, tha se këto njësi nga Batalioni i Forcave Operacionale Rezervë do të mbesin në këtë pjesë të vendit “për të kryer patrullime të

rregullta, në mënyrë që të garantojnë mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit” që jetojnë në komunën e Zveçanit.

Në fillim të vitit të kaluar NATO-ja kishte njoftuar për shtimin e 700 trupave të këtij batalioni në veri pas rritjes së dhunës dhe tensioneve në këtë pjesë të vendit.

Tensionet në veri të Kosovës filluan të rriten më 26 maj 2023, kur serbët në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok kundërshtuan hyrjen në

ndërtesa komunale të kryetarëve të rinj shqiptarë - të zgjedhur në zgjedhjet e prillit të atij viti.

Këto votime ishin bojkotuar nga serbët lokalë dhe partitë serbe. Dhuna kulmoi në Zveçan më 29 maj 2023, kur protestuesit serbë u përleshën me forcat e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Dhjetëra ushtarë dhe protestues u plagosën gjatë përleshjeve.

KFOR-i ka aktualisht mbi 4 400 ushtarë në Kosovë.



Policia e zbulon një laborator droge në Leposaviq, e arreston një të dyshuar



LEPOSAVIQ, 25 SHKURT - Policia e Kosovës njoftoi të dielën herët se e ka zbuluar një laborator droge në një fshat në qytetin verior, Leposaviq, si dhe e ka arrestuar një të dyshuar për këtë rast në Jarinjë, pikën kufitare me Serbinë.

Policia tha në një komunikatë për medie se kishte pranuar informata të shtunën se në një shtëpi në fshatin Granican të Leposaviqit dyshohej se po kultivoheshin bimë të kanabisit.

Njësia antidrogë ka dalë në vendin e ngjarjes dhe “gjatë bastisjes në një dhomë të shtëpisë janë gjetur dhe

sekustruar rreth 23 bimë të mbjella të dyshuar si kanabis, me gjatësi prej 40 centimetrash deri në 1.85 metra, si dhe pasje të tjera të cilat nevojiten për improvizimin e laboratorit (poqa, ventilim etj.)”, thuhet në komunikatë.

I dyshuari, 43 vjeç, u identifikua dhe u kap në pikëkalimin kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë, Jarinjë, sipas komunikatës. Ai është dërguar në paraburgim për 48 orë me urdhër të prokurorit të rastit.

Policia tha se një pjesë të bimëve të dyshuara si kanabis i ka marrë si mostra për testime laboratorike, ndërsa pjesën e

mbetur e ka shkatërruar me urdhër të prokurorit. Kjo nuk është hera e parë që Policia e Kosovës kryen aksione kundër drogës në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe.

Në fillim të vitit të kaluar policia zbuloi tre laboratorë droge në Mitrovicë të Veriut. Po ashtu, në maj të vitit të 2022 policia kishte shkatërruar dy laboratorë droge në Izvor, afër kufirit me Serbinë, ku ishin gjetur edhe sasi të mëdha të bimëve narkotike, të llojit marijuanë. Në prill të atij viti ishte shkatërruar një laborator droge në Zveçan dhe ishin arrestuar katër serbë.

Shumë fëmijë preken nga gripi sezonal, mjekët nuk rekomandojnë antibiotik



Prishtinë, 25 shkurt - **SHUMË** fëmijë këto ditë kanë kërkuar ndihmë mjekësore si pasojë e gripit sezonal. Ekspertët shëndetësorë kanë thënë se fëmijët kryesisht vijnë me ankesa për ethe, temperaturë, skuqje fyti dhe kollë e thatë.

Javët e fundit shumë qytetarë, mes të cilëve edhe shumë fëmijë, janë infektuar nga virozat e stinës, që zakonisht pasohen nga simptoma si ftohje, kollë, dhimbje të fytit, dhimbje trupi dhe temperaturë. Kështu është shprehur për Radio Kosovën, Valbona Dermaku, specialiste e Pediatrisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë

Familjare në Prishtinë. Ajo thotë se gjatë këtyre ditëve kanë pasur fluks më të madh të prindërve, të cilët i kanë sjellë fëmijët e tyre për vizita si pasojë e gripit sezonal. “Është në rritje numri i pacientëve, sidomos qysh nga periudha tetor - nëntor kur fillon koha e virozëve, po ashtu edhe këtyre ditëve kemi pasur fluks të madh të vizitave pediatrike si pasojë e gripit sezonal. Te foshnjat gripi po zgjat pesë deri në shtatë ditë. Fëmijët në dy-tri ditët e para po kanë temperaturë, por që pas ditës së dytë dhe të tretë po fillojnë të stabilizohen dhe kryesisht i trajtojmë me terapi

simptomatike”, tha ajo.

Edhe pediatri Nexhmedin Osmani thotë se këto ditë kanë pasur shumë vizita pediatrie, por që nuk ka qenë raste të rënda. Ai tregon simptomat të cilat iu shfaqën fëmijëve. “Fëmijët kryesisht vijnë me ankesa që kanë kollitje, temperaturë, plogështi. Ndërsa fëmijët e moshës me madhore vijnë kryesisht me kollitje të thatë, e që dyshohet se mund të jetë ndonjë lloj i Covid-19”, tha ai. Sipas profesionistëve shëndetësorë, gripi sezonal te fëmijët zgjatë pesë deri në dhjetë ditë. Ata rekomandojnë që të mos ketë përdorim të antibiotikëve në raste virozash.

Hashani: Pediatra në QKMF-në e kryeqytetit brenda pak vitesh mund të mbyllet

Prishtinë, 25 shkurt - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë që nga 1 marsi pediatria do të funksionojë me vetëm një ndërrim nga ora 07:00 deri në orën 15:00 për shkak se një pediatre do të dalë në pension gjatë këtij muaji. Ndërkaq si pasojë e mungesës

së pediatërve të specializuar dhe në bazë të udhëzimit administrativ, në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor nuk mund të ketë zëvendësime të reja. Kështu thotë kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në

Prishtinë, Valdet Hashani. Ai tregon se parashihet që pediatria në QKMF-në e kryeqytetit brenda pak vitesh të mbyllet si njësi, derisa tregon se aktualisht janë tre pediatër specialistë dhe një shefe e pediatrisë e që, sipas tij, në asnjë rrethanë nuk mund t'i mbulojnë dy ndërrime.



Afaristët serbë ankohen për kushtet ekonomike në Kosovë



PRISHTINË, 25 SHKURT - Derisa Qeveria e Kosovës paralajmëron vende të reja pune për pjesëtarët e komunitetit serb, investime në infrastrukturë dhe forma të tjera të mbështetjes, me qëllim të fuqizimit të tyre ekonomik, disa afaristë serbë shprehin skepticizëm në këtë drejtim.

Vitomir Jaqimoviq nga Leposaviqi dhe Dushko Guxhiq nga Graçanica thonë për Radion Evropa e Lirë se ajo që Qeveria e Kosovës u ofron serbëve nuk është e mjaftueshme. Sipas tyre, parakusht për fuqizimin ekonomik është qarkullimi i lirë i mallrave dhe njerëzve.

Në mes të vitit të kaluar Qeveria e Kosovës mori vendim për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia për, siç tha, arsye sigurie. Kjo ndodhi pasi tre policë të Kosovës u arrestuan nga forcat serbe. Edhe pse policët u liruan nga paraburgimi për t'u mbrojtur në liri, ndalesa mbeti në fuqi.

Duke komentuar këtë çështje, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se masa e tillë është marrë për shkak se "ekziston rreziku që krahas mallrave, në Kosovë të futen edhe armë".

Përndryshe, "Zhvillimi ekonomik për serbët në Kosovë" ishte temë e një tryeze të rrumbullakët që u organizua këtë javë nga Qendra për Dialog Humanitar në Prishtinë.

Çfarë bën Qeveria e Kosovës për serbët?

Në këtë tryezë Bislimi tha se Qeveria e Kosovës ofron mbështetje për kompanitë apo sipërmarrësit e vegjël përmes punësimit të punëtorëve, gjegjësisht përmes subvencioneve për pagesën e pagave mujore. Ai tha se në katër

komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok - Qeveria e Kosovës do t'i mbështesë dy mijë vende të reja pune në sektorin privat. "Deri në 70 për qind e pagës ose me rreth 350 euro do të subvencionohen për gjashtë muaj. Reagimet që morëm nga veriu janë shumë të mira. Sipas parashikimeve të deritashme, nevojiten rreth 2 000 vende të reja pune. Nëse ka nevojë, kjo masë mund të zgjerohet edhe me 2 000 të tjera. Ajo mund të aplikohet edhe në komunat e tjera me shumicë serbe", tha Bislimi.

Përveç katër komunave në veri, janë edhe gjashtë komuna të tjera me shumicë serbe në jug të Lumit Ibër: Graçanica, Shtërpca, Ranillugu, Parteshi, Klokoti dhe Novobërda.

Bislimi u shpreh i bindur se "formalizimi i ekonomisë" do të kontribuojë edhe në zhvillimin ekonomik të serbëve, përkatësisht në regjistrimin e bizneseve, në luftën kundër kontrabandës dhe në mjetet buxhetore të qeverisë për realizimin e projekteve infrastrukturore.

Çfarë thonë afaristët?

Jaqimoviq nga Leposaviqi thotë se pozita e afaristëve serbë është shumë e keqe dhe se gjithçka bëhet "për mbijetesë". Subvencionet e Qeverisë së Kosovës, sipas tij, nuk janë të mjaftueshme, sepse janë të kufizuara në punësimin e punëtorëve. "Punësimi i një apo dy punëtorëve nuk mjafton për aktivitetet ekonomike. Duhet të zgjidhet në një mënyrë tjetër, që malli të hyjë dhe të dalë normalisht", thotë ky biznesmen shumëvjeçar, duke aluduar në

vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia. "Unë nuk shoh që dikush është përfshirë në zgjidhjen e këtyre problemeve. Qeveria e Kosovës mund të ndihmojë nëse i ndryshon vendimet e saj, duke lejuar qarkullimin e mallrave. Mallrat nga Serbia nuk mund të vijnë", thotë Jaqimoviq për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, nuk do të ketë zhvillim ekonomik "derisa politika të ndërhyjë në punën e biznesmenëve".

Guxhiq, biznesmen nga territori i komunës së Graçanicës, beson se Qeveria e Kosovës nuk dëshiron sinqerisht të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të serbëve. Sipas tij, këtij komuniteti i sigurohet minimumi - "vetëm ajo që duhet". "Ajo [Qeveria e Kosovës] mund të bëjë shumë, por nuk do. Thjesht, ajo nuk do që të na ndihmojë", thotë ai.

Guxhiq merret me prodhimin e lëngjeve dhe reçelit, që kryesisht shiten në tregun e Kosovës. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai tregon se biznesin e ka filluar para rreth shtatë vjetësh falë organizatave ndërkombëtare joqeveritare. Ai thotë se asnjëherë nuk ka marrë ndihmë nga Qeveria e Kosovës. Por, sipas tij, afaristët serbë nuk dëgjohen as në Qeverinë e Serbisë.

Rashiqi: Kemi paraparë punësimin e komuniteteve pakicë

Ministri për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiq, tha se vitin e kaluar për herë të parë është realizuar një program zhvillimor ekonomik, përmes të cilit janë investuar rreth tre milionë euro në ekonominë e zonave ku jetojnë serbë. Ai përmendi edhe

strategjinë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, e cila u miratua nga Qeveria e Kosovës në fund të vitit 2023.

Sipas tij, kjo strategji do të fillojë të zbatohet këtë vit dhe buxheti i planifikuar është rreth 32 milionë euro. "Në ata 32 milionë euro që përmenda, është edhe programi ekonomik. Një nga pikat më të rëndësishme të kësaj strategjie është përfaqësimi proporcional i joshqiptarëve në administratën publike", tha Rashiq. Sipas ligjeve të Kosovës, pjesëtarët e komuniteteve pakicë duhet të përbëjnë së paku 10 për qind të të punësuarve në sektorin publik. Deri më tani, sipas Rashiqit, "askush nuk është marrë sinqerisht me këtë çështje".

Sektori civil: Gjendja e afaristëve serbë është "kaotike"

Aleksandar Stojanoviq nga Qendra për Zhvillimin e Komuniteteve Lokale tha se Qeveria e Kosovës nuk ka komunikim me komunitetin serb, se merr vendime pa konsultime dhe se serbët ndiejnë pasiguri për shkak të kësaj. "Më duhet të them se edhe organizatat ndërkombëtare kanë investuar shumë pak në mjediset serbe. Tani kemi nevojë për programe pak më serioze [të Qeverisë së Kosovës] që do të hapin biznese në mjediset serbe. Na duhet ta ndryshojmë qasjen afatgjatë", tha ai.

Gordana Gjorj nga Shoqata e Grave Afariste vlerësoi se situata e paqëndrueshme politike bën që komuniteti shumicë shqiptar t'i bojkotojë produktet e biznesmenëve serbë. "Më gjeni një treg më të madh ku mund të gjeni produkte serbe. Ka

bojkotim të produkteve serbe. Njerëzit tanë kanë probleme me shitjen e mallrave", tha ajo.

Gjorj tha se situata është "kaotike", sepse Qeveria e Kosovës "nuk ka krijuar kushte që komuniteti serb të zhvillohet ekonomikisht". Sipas saj, është e nevojshme që, para së gjithash, të krijohet besim mes institucioneve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. "Veprimet e qeverisë aktuale janë të tmerrshme. Ajo promovon largimin [e komunitetit] dhe nuk forcon zhvillimin ekonomik. Për mua është e pakuptueshme që qeveria merr vendime të cilat dëmtojnë ekonominë dhe komunitetin serb", tha Gjorj. Në këtë kontekst, ajo përmend ndalimin e importit të mallrave nga Serbia dhe ndalimin e përdorimit të dinarit serb me një rregullorë të Bankës Qendrore të Kosovës. "E gjithë kjo krijon frikë te njerëzit, ata nuk e dinë se çfarë të presin. Nuk krijon besim te njerëzit", tha Gjorj.


Bislimi u përgjigj duke thënë se ndalimi i importit të mallrave nga Serbia është në fuqi për arsye sigurie dhe jo ekonomike. "Transportimi i mallrave është keqpërdorur edhe për import të armëve. Prandaj, masat janë marrë për arsye sigurie nga Ministria e Punëve të Brendshme, e jo nga Ministria e Ekonomisë", tha ai.

Disa muaj pas ndalimit të importit të mallrave nga Serbia, grupe të armatosura të serbëve sulmuan Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë, duke vrarë një polic.

Pak ditë më pas Policia e Kosovës sekuestroi një arsenal të madh armësh.

Prishtina zyrtare e akuzoi Beogradin për sulmin e 24 shtatorit, por ai e mohoi çdo përfshirje.

Kontrolli i Fakteve: Si dezinformimi po godet Navalnyn dhe të shoqen



Ditët e fundit një valë dezinformimi ka goditur kundërshtarin politik të vdekur tashmë të Vladimir Putinit, Alexei Navalny dhe gruan e tij Yulia Navalnaya. Trashëgimia politike e disidentit është në shënjestër, përmes përdorimit të imazheve të manipuluar dhe audiove të rreme të krijuara me inteligjencë artificiale. Fjala “nazist” është ndër më të kërkuarat e ditëve të fundit në Itali dhe jo vetëm, në lidhje me disidentin politik rus Alexei Navalny, vdekja e të cilit

rrëfimeve, vendet perëndimore janë të prirura të krijojnë një idhujtari përreth figurës së Navalny-t, pavarësisht lidhjes së tij të deklaruar me nazizmin. Akuzat kundër Navalny-t manifestohen përmes shpërndarjes së imazheve të manipuluar dhe informacioneve mashtruese, të tilla si fotot e rreme të një tatuazh të Adolf Hitlerit, që synojnë të vërtetojnë aderimin e tij në ideologjinë naziste. Edhe pse Alexey Navalny e ka



u njoftua më 16 shkurt. Temat “nazizëm” dhe “neonazizëm” shohin gjithashtu një rritje të madhe, tek shihen të lidhura me emrin e tij. Që nga vdekja e kundërshtarit politik të Vladimir Putinit, narrativa të ndryshme dezinformuese kanë vënë në shënjestër figurën e tij dhe të disa anëtarëve të familjes së tij, siç raportohet nga monitorimi i njësive të ndryshme gazetareske dhe institucionale të kontrollit të fakteve, si AFP dhe Task Force Stratcom e Bashkimit Evropian. Sipas një prej këtyre

konsideruar gjithmonë veten nationalist dhe në një fazë të hershme politike ka marrë pjesë në demonstratat e ekstremitetit të djathtë, si dhe ka shprehur mendime ksenofobe ndaj disa pakicave, ai kurrë nuk ka aderuar në ideologjinë naziste. Gjatë evolucionit të tij politik, ai hoqi dorë publikisht nga pozicionet më radikale dhe më pas i hyri një rruge që shënoi trajektoren e tij kryesore politike deri në vdekje: luftën kundër autoritarizmit joliberal të qeverisë së Vladimir Putinit,

shpesh duke përdorur denoncimin e korrupsionit të institucioneve ruse, si mjetin kryesor të luftës.

Dezinformatat kundër Yulia Navalnayas, gruas së Navalny

Julia Navalnaya, gruaja e disidentit rus që vendosi të vazhdojë trashëgiminë politike të bashkëshortit të saj, është bërë gjithashtu objektivi i sulmeve të dezinformative. Rrëfimi kryesor në lidhje me të ka të bëjë me lehtësinë me të

Putinit, i cili u largua në Britani në vitin 2008, u hoq jashtë kontekstit për të diskredituar gruan e disidentit. “Unë dhe i dashuri im i ri jemi thellësisht të pikëlluar nga vdekja e bashkëshortit tim”, lexohet në një postim në Twitter (X), ku bashkangjitur ndodhet fotoja në fjalë dhe ku deklarata i atribuohet gruas. Fotoja në fakt është e datës 17 gusht 2021, shumë kohë përpara vdekjes së Alexey Navalny, dhe u publikua në profilin e Yevgeny Chichvarkinit në Instagram.

cilën, pas vdekjes së të shoqit, ajo ka nisur marrëdhënie romantike me burra të tjerë. Imazhe dhe audio të ndryshme të manipuluar shoqërojnë këtë informacion të rremë. Një foto e bërë nga agjencia AFP në të cilën Navalnaya përqafon burrin e saj, u retushua duke e zëvendësuar Navalnyn me një mashkull tjetër. Një foto tjetër e Navalnayas së bashku me Yevgeny Chichvarkin, një sipërmarrës rus dhe kundërshtar i zjarrtë i

Sipërmarrësi është gjithashtu një mik i familjes Navalny dhe ka financuar projekte që lidhen me fondacionin e tyre. Po ashtu qarkullon një audio e rremë, e krijuar me inteligjencë artificiale, në të cilin nëna e Alexei Navalny duket se fajëson Navalnayan, se e ka shtyrë djalinë sht që të kthehej në Rusi. Audioja e rreme gjithashtu akuzon Navalnayan se ka përfituar nga vdekja e burrit për të përfituar dhe për të dalë me burra të tjerë. / truthhub – bota.al



Koncepti i Eforatit në Shkencën e të Drejtave të J. G. Fichte

Koncepti i çuditshëm në mendjen e lexuesit të sotëm, aq sa edhe në atë bashkëkohës me filozofin gjerman J. G. Fichte, ka një rol ekstremisht të rëndësishëm në sistemin politik të shtjelluar prej tij.

Eforat vjen nga greqishtja eophoros, dhe njihet në histori si një nga institucionet kryesore të Spartës, roli i të cilit ishte pikërisht ai i mbikqyrjes së fronit të dyfishtë spartan. Fichte e rikthen në modernitet këtë koncept si domosdoshmëri për kapërcimit e kontradiktës së radhës që shfaqet në rrugëtimin e tij filozofik, i cili shpaloset nëpërmjet tezës, antitezës dhe sintezës.

Për të kuptuar Eforatin, bëhet e nevojshme të shpjegohet domosdoshmëria e këtij koncepti në kuadrin e vizionit politik-shtetar të Fichte. Parimi mbi të cilin ngrihet gjithë sistemi është ai i lirisë që formulohet kështu: "Liria ime duhet të shtrihet deri atje sa të mos çënoj lirinë e tjetrit." Pra kemi të dy kahët e lirisë në të njëjtën formulë. Aspekti pozitiv i lirisë përcaktohet nga shtrirja e saj jo në mënyrë të padeterminueshme ad infinitum, por deri në fillimin e sferës së lirisë së qenies racionale tjetër. Kjo e fundit në të njëjtën kohë kthehet edhe në aspektin negativ të lirisë. Kur jam i vetëdijshëm deri ku shtrihet liria ime, kuptoj edhe se përtej cilit cak ajo nuk mund të shkojë.

Pas kapërcimeve dhe tejkalimeve sintetike të kontradiktave të njëpasnjëshme, Fichte arrin në deduksionin e konceptit të shtetit, si një palë e tretë të cilës i transferohet pushteti nga palët që gjithnjë janë potencialisht në konflikt. Shteti vjen në sistem si domosdoshmëria për të mbrojtur jetën, lirinë dhe pronën e personave. Pra, në të njëjtën formë përcaktohet edhe natyra e shtetit pozitivisht dhe negativisht. Aktiviteti mbrojtës i shtetit përbën aspektin pozitiv të natyrës së tij, ndërsa kufizimi i tij tek ky aktivitet mbrojtës shfaq aspektin negativ. Ky është roli absolut i shtetit dhe prandaj Fichte e përkufizon si institucionin që lind prej mosbesimit. Pra, prej mosbesimit të personave ndaj njëri-tjetrit dhe koherencës së tyre në mbajtjen dhe zbatimin e ligjit tekta bashkohen në formimin e shoqërisë mbi idenë e njohjes dhe nevojës reciproke. Qeveria është forma e përqendruar e pushtetit të transferuar dhe për Fichte nuk ka kuptim t'i ndash pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe atë juridik, përfaqë një efektshmëri më e madhe rezulton nga përqendrimi i tyre. Çështja për të nuk shtrohet në ndarjen e pushteteve në mënyrë që të kontrollojnë njëri-tjetrin, siç jemi mësuar me skemën demokratike republikane. Fichte nuk synon të ngarkojë pushtetet edhe me detyrën e kontrollit përveç atyre të shërbimit publik që janë mëse të mjaftueshme. Po ashtu, tekta diskuton çështjen e zyrarëve public ndihet qartë bindja e tij se një administratë e drejtë nuk varet vetëm nga kontrolli por nga botëkuptimi dhe morali i zyrarëve. Kështu, që në nisje qartësohen kriteret e larta të cilat përcaktojnë dinjitetin e të qenit

një zyrar. Pra, qeveria është njëkohësisht pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. E drejta e apelit për vendimet e tyre përjashtohet. Të kuptohemi, Fichte nuk është arbitrar në argumentat e veta por logjikisht koherent. Të paktën përse i përket Shkencës së të Drejtave, të cilën e ka merak ta dalloj nga Shkenca e Politikës, përfaqë e para themelohet në reflektime dhe deduksione a priori, ndërsa e dyta në materiale empirike. Kjo nuk do të thotë që shkenca e Fichte nuk ka aplikueshmëri në botën e ndjeshme, siç shprehet ai, dhe kjo duket qartë tekta po trajtohet me terma konkret shteti, roli i tij dhe interesi i personave. Me pak fjalë, jetesa sa më dinjitoze dhe e lirë racionalisht është gjithë themeli i sistemit. Qeveria, pra, është i treti mes dy personave që bashkohen për të formuar shoqërinë, por që përsëri kontradikta shfaqet në formën e mosbesimit ose pasigurisë se tjetri do të respektoj ligjin e lirisë dhe rrjedhimisht të pronës, arsytet për të cilin ndodh bashkimi shoqëror (commonwealth).

I treti është neutrali, dhe i treti i pajisur me pushtetin e të gjitha palëve dhe njëkohësisht me përgjegjësinë ndaj të gjitha palëve, nuk mund të jetë tjetër veçse në identitet me to. Vullneti i përbashkët identifikohet me vullnetin partikular. Nëse interesi i secilës palë është siguria e jetës, lirisë dhe pronës (të drejtat origjinale të dedukuara nga Fichte), dhe për të realizuar (mbrojtur këtë të drejtë-interes) përcaktohet një i tretë i plotfuqishëm, atëherë, interesi i të tretit është mbrojtja e jetës, lirisë dhe pronës së të gjithëve. Kështu, vullneti partikular i shtetit identifikohet me vullnetin e përgjithshëm të personave që e caktuan, dhe nga ana tjetër, vullneti partikular i qenieve racionale i shprehur në dëshirën për të mbrojtur jetën, lirinë dhe pronën e vetë, identifikohet me vullnetin e përgjithshëm në formën e shtetit që i mbron ato. Fryma rusoane ndihet fortë në këtë teori politike të vullneteve. Pyetja që natyrisht lind, e që edhe Fichte e ngrre, ka të bëjë me momentin e radhës, pra me kontradiktën: A nuk mund të abuzoj qeveria me pushtetin dhe të shtyp popullin? Si do të kundërshtohet një qeveri e tillë përfaqë e drejta e apelit përjashtohet duke qenë se në një shtet si ky, i instaluar racionalisht, vullneti i qeverisë dhe i popullit identifikohet? Këtu shfaqet koncepti i Eforatit si sinteza.

Pra, çfarë është dhe çfarë bënë Eforati për Fichte?

Grumbullimi i popullit për të gjykuar mbi veprimtarinë e qeverisë shihet si një procedurë e drejtë përfaqë pushteti është i popullit, por nga ana tjetër Fichte mendon se populli nuk mund të mblidhet apo të thirret nga persona privat në çështje, sepse edhe ky



fenomen mund të ketë nuancat e veta të interesit apo të gjykimit të padrejtë. Si rrjedhim bëhet e qartë se nevojitet një institucion i specializuar për këtë detyrë. "Si mundet kjo kontradiktë të zgjidhet? Është e zgjidhur; Kur kushtetuta është bërë të sigurojë që më parë, që populli duhet, në raste të caktuara, të thirret së bashku në konvent." Më tej theksohet se: "Populli kurrë nuk duhet të thirret pa një domosdoshmëri absolute; por në çastin që është e domosdoshme, ata duhet të thirren së bashku njeherazi, dhe duhet të kenë fuqinë të gjykojnë."

Eforati është institucioni detyrat e të cilit mund të reduktohen në tre folje: kontrollon, pezullon, grumbullon. Eforati nuk ka funksione administrative të tipit ekzekutiv apo gjyqësor. Detyra e tij kryesore është të kontrollojë punën e administratës me qëllim sigurimin e identitetit të vullneteve mes qeverisë dhe popullit. Këtë detyrë mund ta kryej nëpërmjet kërkimit të informacionit apo vëzhgimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve ekzekutive, por në raport me qeverinë nuk ka asnjë të drejtë dhe detyrë më tepër se kaq. Sigurisht që qeveria nuk ka veçse të bindet kërkesave për informacion të Eforatit, e ndoshta në rastin më të mirë do të ishte t'ia paraqiste vetë, megjithatë, detyra mbikqyrëse ka një ngjashmëri me KLSH-në e përditshmërisë sonë, vetëm se mbikqyrja shtrihet në të gjitha aspektet e aktivitetit qeverisës pa harruar kurrë interesin e shoqërisë së përbashkët mbi të cilën ajo është themeluar.

Në momentin që qeveria rezulton se ndodhet në dy situatat që nuk duhet të gjendet kurrë: të abuzimit me pushtetin dhe të rënies në kontradikt me veten, Eforati nëse nuk vërteton rregullimin e gjendjes prej qeverisë (ndaj të cilës nuk ka asnjë lloj të drejte urdhëri për veprime të caktuara) kryen fazën e dytë të detyrës së vetë. Pezullimi i qeverisë dhe çdo veprimtarie të ndërmarë nga kjo e fundit është i menjehershëm. "Por Eforati ka pushtetin e ndalimit absolut – pushtetin të ndaloj jo ekzekutimin e këtij apo atij vendimi partikular të qeverisë, sepse atëherë do të ishte një gjykatës, dhe pushteti ekzekutiv nuk do të ishte suprem, por të pezulloj plotësisht administrimin e ligjit dhe qeverinë në të gjitha

degët." Bindja ndaj urdhërit për pezullim prej Eforatit është e padiskutueshme dhe kjo mbështet edhe nga fakti se hapi tjetër i menjehershëm që kryen Eforati është thirrja dhe grumbullimi i popullit. Çështjen e grumbullimit Fichte mundohet ta trajtoj edhe në kuadrin e qyteteve apo shteteve të mëdha, edhe pse për përfytyrimin e tij teorik preferon qytetet e vogla, megjithatë shprehet për grumbullimin e njerëzve në sheshet publike e kryesore me daljen e lajmit për thirrjen e Eforatit, në mënyrë që të jenë gati për çdo veprim të paparashikueshëm e agresiv të qeverisë së thirrur në gjykim. Një metodë e risjell nga Badiou tek Rizgimi i Historisë, edhe pse në një kontekst krejt tjetër, tekta trajton revoltat e "Pranverës Arabe" dhe mundohet të ndërtoj një konstrukt konceptual të revoltës.

Ky pezullim sjell si pasojë edhe shkarkimin e të gjitha vendimeve të shkuara të qeverisë të themeluara mbi kontradiktën apo abuzimin, e si rrjedhim rikthen subjektet e prekura në gjendjen e mëparshme. Vendimi i konventës ka fuqi prapavepruese. "Themeli i kësaj fuqie retroaktive është ky: pala që humbi ndaj gjykimit të padrejtë, e kishte të ndaluar apelin ndaj tij, përfaqë supozohet se vullneti i gjyqtarit që e deklaroi atë ishte në përputhje me vullnetin e përgjithshëm. Në rastin e tashëm e kundërta shfaqet, dhe kur themeli bie tutje, ashtu bie edhe i themeluari. Rrjedhimisht, ai gjykim anulohet." Askush, në kushtet e pezullimit të qeverisë nuk duhet t'i bindet asaj, dhe nga ana tjetër Fichte thekson se çdo akt i qeverisë në kushtet e pezullimit konceptohet si rezistencë ndaj popullit. "Nga momenti i këtij pezullimi të lajmëruar, çdo akt i qeverisë, përfaqë ajo ushtron pushtet ekzekutiv, është rezistencë ndaj vullnetit të përgjithshëm të popullit, siç është i shprehur përmes Eforatit, dhe pra, është një rebelim, që duhet ndëshkuar si i tillë."

Lajmërimi i pezullimit është në të njëjtën kohë edhe thirrja për mbledhjen e konventës popullore, në të cilën, vetëm ky i fundit është gjyqësor ndaj qeverisë. Eforati është i përjashtuar nga procesi i gjykimit duke qenë se është palë e interesuar, pra qëndron si pala akuzuese. Rezultati i gjykimit të konventës bëhet ligj kushtetues i vendit. Sigurisht që Fichte i qëndron parimit të arsyes dhe lirisë që i bën njerëzit bashkë që në origjinë, e për këtë beson se populli do të gjykojë drejtë. Megjithatë, intoleranca e tij, gjithmonë brenda kuadrin racional të sistemit, shfaqet tek ndëshkimi që i caktohet palës së shpallur fajtoze. Me marrjen e vendimit populli do të dënoj ose qeverinë, ose Eforatin për tradhti të lartë.

"Eforatin sepse ndërpreu administrimin e ligjit pa shkak të drejtë; qeverinë sepse ka abuzuar me pushtetin që i është besuar për të shtypur ligjin." 9 Në pamje të parë argumenti i Fichte duket i vendosur vetëm në çështjen praktike të pezullimit të punëve të administratës apo të shtypjes së ligjit prej saj, por në kuadrin e sistemit ky pezullim dhe shtypje e ligjit kuptohet si çënim i drejtpërdrejtë i asaj që njeriu është, pra një qenie racionale, e lirë dhe me pronë, të drejta të cilat Fichte i dedukton prej konceptit të personalitetit. Pra, personaliteti i njeriut preket në njërin nga të dy rastet, dhe intoleranca ndaj këtij çënimi është kategorike përfaqë sistemi ngrihet mbi dhe për këto aspekte të personalitetit të njeriut. Anëtarët e Eforatit për Fichte duhet të jenë burra mbi të 60-dhjetat, të edukuar e kulturuar me virtyte të theksuara morale e civile. Përzgjedhja e tyre duhet bërë nga populli mes popullit, pra, mundësia e aplikimit për një detyrë të tillë përjashtohet. Fichte nuk e pranon mundësinë e konkurrencës në këtë kontekst, përfaqë efori ka një detyrë dhe përgjegjësi sublimë pa e këthyer në karrierë. Ndryshe nga zyrarët e administratës që zgjidhen për jetë, eforët janë të përkufizuar në afatin e shërbimit të tyre. Me ribotimin e vitit 1812 të Shkencës së të Drejtave, Fichte shkruan një notë të gjatë në lidhje me

konceptin e Eforatit. Qëndron krah parimeve të ligjit të shtjelluar prej tij, por tashmë ka ndryshuar mendim në lidhje me praktikitetin e Eforatit. "Për sa ka të bëjë me praktikueshmërinë e një pushteti të tillë kontrollues, unë duhet tani, pas një konsiderimi të pjekur, të vendos kundër tij." I zhgënjyer nga pasojat dhe zhvillimet e Revolucionit Francez, filozofi tashmë shpreh skepticizëm tek ndjenja civile dhe ligjore e njerëzve. "Kush, do të kontrollojë Eforatin, që të mos fillojë një revolucion për një arsye apo për një tjetër, edhe pse qeveria nuk e ka çenuar ligjin? Përsëri: A nuk do të provonte qeveria, e cila zotëron të gjithë pushtetin në duart e veta, të shtyp Eforatin që në fillim?" Çështja e eforëve të korruptuar nuk i shpëton, por për atë, ka të njëjtën bindje që ka theksuar edhe gjatë tekstit: "Një popull eforët e të cilit, të zgjedhur nga më të mirët e popullit, mund të jenë të korruptuar aq sa për sjellje të tillë, nuk meriton një qeveri më të mirë, dhe nuk është i aftë për një më të mirë." Megjithatë, në frymën e shekullit në të cilin jetoi dhe punoi me shpirtin e vetë për shpirtin e të gjithëve, Fichte i dorëzon shpresat e veta tek kultura dhe morali si mundësitë e fundit të zhvillimit human. "E vetmja gjë prej të cilës të mund të presim përmirësim është progresi i kulturës dhe moralitetit, e si rrjedhim, një rritje e influencës së Eforatit në këtë progres."

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Kosova pësoi humbje nga Azerbajxhani

PRISHTINË, 25 SHKURT - Përkundër tre çerekeve të barabartë, Kosova pësoi humbje nga Azerbajxhani me rezultat 87:77 (19:19, 24:25, 16:16, 28:17). Ndeshja në fakt ka qenë e baraspeshuar për 30 minuta, ku

asnjëra nuk arriti të shkëputej, por u vendos në dhjetë minutat e fundit, ku vendasit me përkrahjen e publikut arritën të fitojnë 87:77, ndërsa te Kosova u lënduan Dardan Berisha dhe Meriton Ismaili. Te Kosova u

dalluan Dardan Kapiti me 19 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime, Musab Mala me 16 pikë e gjashtë asistime dhe Dardan Berisha me 20 pikë e katër asistime. Kosova dhe Azerbajxhani kanë nga një fitore

dhe një humbje në Rrethin e Parë Parakualifikues për FIBA Kupën e Botës 2027. Sfidat e radhës për "Dardanët" do të jenë në muajin nëntor, në udhëtim ndaj Zvicrës dhe Irlandës.



Gara për titull bëhet edhe me interesante

"Epoka e re"

PODUJEVË, 25 SHKURT - Llapi nuk ka arritur t'i gëzohet fitores së shumëdëshiruar përballë Prishtinës në stadiumin "Zahir Pajaziti" të stërmbushur, në kuadër të javës së 22-të në Albi Mall Superligë. Kësisoj, skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina e ka lëshuar rastin që me fitore ta zbrësë nga fronti kampionin në fuqi, Ballkanin, i cili vazhdon të kryesojë edhe pas kësaj jave me një pikë më shumë se Llapi. Ndeshja në "Zahir Pajaziti" u karakterizua me lojë të fortë, por me raste të pakta shënimi. E barazimet e Ballkanit dhe Llapit i ka shfrytëzuar Drita, që para tifozëve të vet ka shënuar fitore në duel me Dukagjinin, me rezultat 2-0, duke u rikthyer fuqishëm në garën për titull. Tani

skuadra gjilanasë ka vetëm dy pikë më pak se lideri i renditjes. Raddy Ovouka në minutën e 55-të shënoi për 1-0, kurse Samson Ebuka Obioha, e dyfishoi epërsinë në minutën e 71-të. Ndërkohë përballja e dy skuadrave të fundit në renditje, Lirisë dhe Fushës Kosovës, e zhvilluar në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren është mbyllur pa fitues dhe pa gola. Mysafirët patën mundësi të artë për të arkëtuar tri pikë, por gjuajtjen e Florent Hajdarit nga pika e bardhë e priti portieri Stivi Frashëri. Kampioni dhe lideri aktual në Albi Mall Superligë, Ballkani ka bërë një tjetër hap fals në këtë fillim të stinorit pranveror. Skuadra e drejtuar nga Ilir Daja në kuadër të javës së 22-të ka barazuar 1-1 me Gjilanin, para tifozëve të vet në Suharekë. Para kësaj ndeshje, portokallezjntë kanë pësuar



humbje ndaj Dritës dhe kanë barazuar me Feronikelin. Si rrjedhojë ata tashmë rrezikojnë ta humbin pozitën e liderit pas kësaj jave. Edvin Kuç kaloi Ballkanin në epërsi në minutën e 19-të, por një pikë gjilanasve ua siguroi Elvedin Heric, nga penalltia në minutën e

45-të. Në ndeshjen tjetër të ditës së sotme, Malisheva shënoi fitore me përmbysje të rezultatit ndaj Feronikelit 74', me shifrat 2-1. Robert Rrahmani kaloi skuadrën e Shefki Kuqit në epërsi në minutën e 60-të, por për fitoren e Malishevës u kujdes Drilon

SUPERLIGA

Ballkani - Gjilani	1-1
Malisheva - Feronikeli 74	2-1
Llapi - Prishtina	0-0
Drita - Dukagjini	2-0
Liria - Fushë Kosova	2-0

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	22 45
2. Llapi	22 44
3. Drita	22 43
4. Malisheva	22 38
5. Prishtina	22 31
6. Dukagjini	22 30
7. Feronikeli 74	22 23
8. Gjilani	22 22
9. Fushë Kosova	22 12
10. Liria	22 10

Hazrollaj, me dy gola të shënuar (78', 89'). Me këtë fitore Malisheva shkon në kuotën e 38-të pikëve në vendin e katërt.

Rahoveci fiton superderbin në Ferizaj

RAHOVEC, 25 SHKURT - Rahoveci ka përballuar një ofensivë të Kastriotit në minutat e fundit dhe ka fituar superderbin e xhiros së 17-të të Superligës së Kosovës në hendboll. Rahoveci e mposhti Kastriotin me rezultat 36:34. Për Rahovecin është fitorja e 17-të rresht. Udhëheq në tabelë me plot 34 pikë. Kastrioti është i katërti me 20 pikë. Ndeshja ka arsyetuar epitetin e derbit, ndonëse mysafirët ishin vazhdimisht në epërsi. Rahoveci ka hapur më mirë ndeshjen dhe nisi shkëputjen e shpejtë në rezultat. Në pjesën e parë ishte vazhdimisht në epërsi. Pas 30 minutave lojë rezultati ishte 20:14 për "vreshtarët". Vendasit megjithatë nuk janë dorëzuar. Kanë luftuar në pjesën e dytë për t'u afruar në një gol në minutën e 60-të, 35:34. Rahoveci megjithatë mbajti topin deri në fund dhe



shënoi golin për 36:34 dhe për fitoren shumë të madhe. Victor Alonso i shënoi 11 gola për Rahovecin. Nëntë i kishte Alban Haziri, ndërsa shtatë i shënoi Jon Muqolli. Te Kastrioti, Deniz Terziqi

i kishte 11 gola. Nga gjashtë i shënuan Rron Ramadani e Lulzim Shabani. Po të shtunën, Besa Famgas e mposhti Vëllaznimin me rezultat 46:17. Prishtina fitoi ndaj Vushtrrisë me rezultat 46:26.

Triumf i lehtë nga Peja 03

PEJË, 25 SHKURT - Peja 03 ka fituar lehtësisht ndaj UnitedBasketball me rezultat të përgjithshëm 95:62 (29:12,16:13,23:26,27:11). Që nga fillimi e deri në fund vajzat nikoqire patën nën kontrollin e tyre ndeshjen. Pjesa e parë u mbyll 45:25. Çereku i tret i takoi UnitedBasketball që arritën të shënojnë 26 pikë por kjo nuk mjaftoi as për t'u afruar rezultatit që kishte krijuar në pjesën e parë Peja 03. Peja 03 hyri në çerekun e katërt me super-seri prej 13-4 duke e thëlluar edhe më shumë krizën e gjilanasve, ndërsa ndeshja në fund u mbyll me rezultat 95:62. Për fitoren e Peja 03 u dalluan Jenna Mastellone me 23 pikë, 10 kërcime dhe 5 asistime si dhe Zërina Shatri me 21 pikë, 5 kërcime dhe 1 asistime. Kurse tek



UnitedBasketball, Anesa Korqa, pati efikasitetin më të lartë me 13 pikë e 4 kërcime. UnitedBasketball matematikisht ka rënë nga Superliga Femrat dhe vitin tjetër garon në Ligën e Parë Femrat, ndërsa Peja 03 do të jetë pjesë e "play-off"-it këtë edicion.

Liverpooli mposhti Chelsea dhe fiton Carabao Cup

Liverpool, 25 shkurt - Liverpooli e ka fituar trofeun e parë për këtë vit. "Reds" fituan në finale të Carabao Cup ndaj Chelseat

me rezultat minimal 1-0 pas vazhdimeve. 90 minutat e rregullt u mbyllën pa gola të shënuar. Përkundër

mungesave të mëdha të lojtarëve kyç, Liverpooli arriti të shënonte në minutën e 116-të për fitoren e këtij trofeu. Ishte

Virgil van Dijk që shënoi golin e fitores dhe golin e trofeut për Liverpoolin që po vazhdon me formë të mirë.





SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar për Edukim Financiar
Grada e pozitës:	gjashtë (6)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	për Marrëdhënie me Publikun dhe Edukim Financiar,
Divizioni:	për Edukim Financiar dhe Komunikim me Publikun
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit për Edukim Financiar dhe Komunikim me Publikun

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Realizon detyrat e parapara në kuadër të fushës së Edukimit Financiar dhe Komunikimit;
- Bën përgatitjen e dizajnimin e materialeve, paraqitjen dhe editimin e materialeve edukative të BQK-së;
- Angazhohet dhe kontribuon në organizimin dhe menaxhimin e ngjarjeve, të organizuara nga BQK;
- Në vazhdimësi bën evidentimin e sfidave që dalin nga komunikimi me publikun dhe kontribuon në adresimin efikas të tyre;
- Bashkëpunon në koordinim me Departamentin e Teknologjisë Informativ/BQK, për çështjet teknike apo operative të Platformës;
- Bashkëpunon me institucionet financiare të cilat janë pjesë e Platformës, lidhur me imputet e institucioneve në aspektin teknik e funksional;
- Angazhohet në procesin e zhvillimit dhe përgatitjes së Platformës për Krahasimin e Normave të Interesit;
- Angazhohet në mbarëvajtjen e punëve që kërkojnë lidhur me funksionimin e rregullt të platformës;
- Në baza ditore bën monitorimin e Platformës dhe identifikon dhe eviton parregullsitë eventuale të cilat mund të paraqiten.
- Analizon kërkesat për ndryshim ose shtim të funksioneve në Platformë si dhe propozon ide e ndërmer iniciativa apo ofron zgjidhje adekuate;
- Komunikon dhe ofron konsulta, dhe koordinon aktivitetet sipas nevojës për pjesëmarrësit e platformës së krahasimit të normave të interesit, si dhe për palët e treta;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolegët e Departamentit, angazhohet në menaxhimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante lidhur me çështjet e komunikimit;
- Detyra tjera të cilat delegohen nga mbikëqyrësi apo personit të autorizuar nga Mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, IT-së ose të ngjashme (që ndërlihen me fushën e ekonomisë dhe IT-së bazuar edhe në përshkrimin e vendit të punës);
- Të paktën 2 vite përvojë pune me aplikacione kompjuterike në fushën e ekonomisë dhe njohuri mbi produktet dhe shërbimet e institucioneve financiare;
- Njohuri të avancuara të punës me kompjuter, sidomos me **aplikacione kompjuterike**, pastaj në programet e Microsoftit si: Adobe Photoshop, Premiere, After Effects, Coral Draw – të preferueshme (dëshmitë përkatëse, certifikatat, etj);
- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **11 mars 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Službenik za finansijsku edukaciju
Stepen pozicije:	šest (6)
Trajanje zapošljavanja:	na neodređeno vreme
Odeljenje:	za odnose sa javnošću i finansijsku edukaciju,
Odsek:	za finansijsku edukaciju i odnose sa javnošću
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za finansijsku edukaciju i odnose sa javnošću

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja poslove predviđene u oblasti finansijske edukacije i komunikacije;
- Priprema i izrađuje materijale, predstavlja i uređuje edukativne materijale CBK-a;
- Angažuje se i doprinosi organizaciji i upravljanju događajima koje organizuje CBK;
- Kontinuirano evidentira izazove koji proizilaze iz komunikacije sa javnošću i doprinosi njihovom efikasnom rešavanju;
- Sarađuje u koordinaciji sa Odeljenjem za informacione tehnologije/CBK, na tehničkim ili operativnim pitanjima Platforme;
- Sarađuje sa finansijskim institucijama koje su deo Platforme, u vezi sa inputima institucija u tehničkom i funkcionalnom aspektu;
- Angažuje se u procesu razvoja i pripreme Platforme za poređenje kamatnih stopa;
- Angažuje se na odvijanju radova koji su potrebni u vezi sa redovnim radom platforme;
- Svakodnevno prati Platformu i identifikuje i izbegava eventualne nepravilnosti koje se mogu pojaviti.
- Analizira zahteve za izmenom ili dodavanjem funkcija u Platformi kao i predlaže ideje i preuzima inicijative ili nudi adekvatna rešenja;
- Komunicira i nudi konsultacije, te koordinira aktivnosti po potrebi za učesnike platforme za poređenje kamatnih stopa, kao i za treća lica;
- U saradnji sa supervizorom i kolegama iz Odeljenja, bavi se vođenjem interne i eksterne komunikacije;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama u vezi sa pitanjima komunikacije;
- Druge zadatke koje delegira supervizor ili lice koje on ovlasti.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, informatike ili slično (koja se odnosi na oblast ekonomije i informacionih tehnologija na osnovu opisa radnog mesta);
- Najmanje 2 godine radnog iskustva sa računarskim aplikacijama iz oblasti ekonomije i poznavanje proizvoda i usluga finansijskih institucija;
- Napredno poznavanje rada sa računarom, posebno sa **računarskim aplikacijama**, zatim u Microsoft programima kao što su: Adobe Photoshop, Premiere, After Effects, Coral Draw - poželjno (relevantni dokazi, sertifikati itd);
- Napredno poznavanje engleskog jezika

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije koju je imao i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog fonda penzione štednje (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura prijave:

- Zadnji rok za prijavu je **11 mart 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

